



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 467 Prot.

Tiranë, më 03 04 2018

VENDIM Nr. 71, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Orikos"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Asoc. Saimir Shpuza dhe Prof. Jean Terrier, Universiteti i Gjenevës, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Orikos"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Asoc. Saimir Shpuza dhe Prof. Jean Terrier, Universiteti i Gjenevës, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - a) Gërmime në sektorin e Akropolit:
 - Vijimi i gërmimit në kompleksin kishtar. Me gërmimet e këtij viti synohet të përfundojë zbulimi total i dy kishave në mënyrë që të dokumentohet planimetria e tyre e plotë. Në jug dhe në perëndim të kishave do të kryhen 2 sondazhe të tjera në murin fortifikues të Akropolit.
 - b) Gërmime në sektorin e Monumentit me funksion hidrik:
 - Kryerja e një gërmimi ekstensiv në të dy ekstremet e mureve anësore;
 - Gërmimi do të zgjerohet edhe në drejtim të lindjes në mënyrë që të zbulohet një pjesë e mirë e murit rrethues që kalon në këtë pjesë të qytetit.
 - c) Gërmime në sektorin e Murit Fortifikues:
 - Tek porta hyrëse e qytetit e gërmuar edhe gjatë fushatave të vitit 2016-2017;
 - Rimarrja e gërmimeve pranë murit të lagunës;

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

- Sondazh në pjesën perëndimore të kodrës.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre. brenda vitit 2018.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
 4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

